

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një vit në krye të Mitropolisë së Korçës/ Hirësia e tij, Anastas: Lutjet tuaja janë ajo që kërkoj
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/nje-vit-ne-krye-te-mitropolise-se-korces-hiresia-e-tij-anastas-lutjet-i475317
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 10:13:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 09:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ecc9774de7eaa703337dac2c5c5093de2a5aa7204a89cdac36acdd25f83b8e58
TEKSTI	1532519001e2bc62f01c13ec5cf66e569c18649afe68910b67860ce406fef0e1
PAMJA	e3288f8b3c36ab242c6bc678cd9c4b389f2d7f6cf4a7502f021d73021d42ed5f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8394c7fe332f57b8358a0a38ea22c2a269c3e7875b20c99210b2b9c9dd933c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b8394c7fe332f57b8358a0a38ea22c2a269c3e7875b20c99210b2b9c9dd933c6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x


12:00 Kronika

Në vijim të bashkëpunimit operacional dhe informativ me ho...

Një vit në krye të Mitropolisë së Korçës/ Hirësia e tij, Anastas: Lutjet tuaja janë ajo që kërkoj



27 Shtator 2026, 11:56, Aktualitet CNA



Një vit nga dita kur u fronëzua si Mitropolit i Korçës, Hirësia e Tij Anastas ka kremtuar këtë përvjetor me një liturgji të shenjtë në Katedralen "Ngjallja e Krishtit". Që prej orëve të para të mëngjesit, besimtarë dhe klerikë janë bërë pjesë e kësaj dite të veçantë për Mitropolinë e Korçës, ndërsa pas liturgjisë, Mitropoliti Anastas ka përcjellë mesazhin e tij për vitin e parë të shërbimit në këtë detyrë.

Duke iu rikthyer fjalëve të thëna një vit më parë, në ditën e fronëzimit, Hirësia e Tij Anastas tha se qëllimi i tij nuk ishte thjesht të merrte titullin e Mitropolitit, por të arrinte të fronëzohej në zemrat e njerëzve.

Një vit më pas, ai bëri një reflektim mbi këtë rrugëtim, duke folur për përgjegjësinë që mbart kjo detyrë dhe për marrëdhënien që dëshiron të ndërtojë me komunitetin. Në fjalën e tij, Mitropoliti kërkoj nga besimtarët jo duartrokitje, por lutje, duke kërkuar prej tyre urtësi, durim, guxim dhe përlësi për të vijuar shërbimin e tij. Mbi të gjitha, ai kërkoj dashuri për të gjithë njerëzit, pa dallim, duke theksuar se misioni i tij është t'u shërbejë të gjithë banorëve të kësaj zone dhe të përcjellë tek ata dashurinë e Perëndisë.

Një vit më parë, në ditën e fronëzimit, Hirësia e Tij Anastas u shpreh se dëshira e tij ishte të mos mbetej vetëm Mitropolit i Korçës, por të bëhej për njerëzit një atë dhe një vëlla. Një vit më pas, ai tha se nëse kjo është arritur sadopak, e konsideron si arritjen më të madhe të këtij viti shërbimi.

"Unë para një viti erdha këtu të fronëzohem nga Sinodi i Shenjtë me në krye Kryepiskopin si Mitropolit i Korçës. Dhe në qoftë se e mbani mend në meshën e parë kur fola, ju thashë se nuk është ky qëllimi im, sepse kjo është një gjë që të jepet shpeshherë pa pasur dhe merita të mëdha. Qëllimi im, ju thashë atë ditë, është që të fronëzohem, nëse mundet, në zemrat tuaja. Dhe në qoftë se në këtë vit kjo është arritur sadopak, që të mos jem mitropolit i juaj, por të arrij të bëhem sadopak ati dhe vëllai juaj, kjo është për mua arritja më e madhe"

Duke bërë një bilanc të vitit të parë, Mitropoliti Anastas tha se gjithçka që është bërë ka qenë për lavdi të Perëndisë, ndërsa për ato që ende nuk janë realizuar, mori përgjegjësinë personale. Në këtë ditë, ai tha se nuk kërkon duartrokitje, por lutjet e besimtarëve për ta udhëhequr në shërbimin e tij.

"Ato që kemi bërë këtë vit, që nuk kemi bërë pothuajse asgjë, por ato gjëra që kemi bërë, janë të gjitha për lavdi të Perëndisë dhe për të gjitha ato gjëra që duheshin bërë dhe që nuk janë bërë, përgjegjësia është personale e imja. Në këtë ditë do të thoja që nuk i dua duartrokitjet tuaja. Jo se nuk i dua, i dëshiroj, por nuk dua që të më jepni duartrokitje sot. Edhe urimet patjetër që i dua. Por ajo që unë pretendoj edhe kërkoj dhe ju lutem me

perulësi të me jepim, janë tuaj tuaja.


Por mbi të gjitha, lutja që kërkoj nga besimtarët ishte për dashuri, pa dallime mes njerëzve. Ai tha se dëshiron t'i shohë të gjithë banorët e kësaj zone njësoj dhe t'u shërbejë përmes mësimit të Kishës dhe asaj që mund të bëhet në komunitet.

"Të luteni tek Perëndia që të më japë urtësi kur duhet të marr vendime; të më japë durim atëherë kur unë duhet të pres; të më japë edhe guxim atëherë kur duhet të flas; edhe të më japë përlësi atëherë kur është e udhës që të hesht. Por t'i luteni Perëndisë para së gjithash që të më japë dashuri; që të mos ndaj njerëzit në të rëndësishëm apo të parëndësishëm; që të mos i ndaj njerëzit në të afërt ose në të largët; por të shikoj vetëm një kategori njerëzish: atë për të cilën Perëndia më dërgoi në këtë qytet dhe në këtë Mitropoli, grigjën e Perëndisë, popullin e zgjedhur të tij, të gjithë bashkëqytetarët, të gjithë banorët e kësaj zone, të cilët në një mënyrë ose në një tjetër do të vijnë në kontakt me mua. T'i shikoj të gjithë njerëzit njësoj e të përpiqem që të shfaq tek ata dashurinë e Perëndisë nëpërmjet mësimit të Kishës dhe nëpërmjet asaj të paktës që ne mund të bëjmë."

Në përfundim të fjalës së tij, Mitropoliti Anastas uroi që vitet e ardhshme të jenë një rrugëtim i përbashkët, me përparim jo vetëm në vepra materiale, por mbi të gjitha në besim, përlësi dhe dashuri. Në këtë ditë të veçantë për Mitropolinë e Korçës, Kisha i dha gjithashtu ofiqin e Stavrofor Ikonomit At Kostandin Mujos, i cili prej shumë vitesh shërben në këtë Mitropoli, duke u përcjellë nga besimtarët urimi: "I denjë!"

"Vëllezër dhe motra, Perëndia na bekoj këtë vit dhe të lutemi që të na japë shumë vite së bashku, që të përparojmë jo në vepra materiale, por të përparojmë në besim, të përparojmë në përlësi dhe të përparojmë në dashuri. Edhe një herë dua t'ju falenderoj të gjithëve. Me dashuri dhe me përlësi e pranojeni këtë falenderim. Ju falenderoj sërish për prezencën tuaj, për fjalët tuaja, për gjithçka kemi kaluar bashkë në Kryepiskopatën e Shenjtë të Tiranës, në shembullin dhe në udhëzimin e atit tonë të përbashkët, Kryepiskopit të paharruar Anastas. Vëllezër dhe motra, në këtë ditë të bekuar të kishës sonë, Kisha ka vendosur që t'i japë ofiqin e Stavrofor Ikonomit njërit prej vëllezërve tanë të dashur, At Kostandin Mujos, i cili prej shumë vitesh shërben në këtë mitropoli me thjeshtësi, me dashuri dhe me përlësi. Le të lexojmë uratën dhe le të themi të gjithë së bashku: I denjë!"

Në përmbyllje të kësaj dite të veçantë, Hirësia e Tij Anastas uroi që rrugëtimi i nisur një vit më parë të vijojë së bashku me besimtarët e Korçës, me më shumë besim, përlësi dhe dashuri. Për të, përvjetori i parë i fronëzimit nuk është vetëm një datë për t'u shënuar, por një moment reflektimi mbi përgjegjësinë dhe misionin që i është besuar./ **CNA**





Të sugjeruara

Shkëlqimi dhe rënia e Agasit, me Vlora Hysenin në krye të SHISH

"Asnjë takim bilateral"/ Zhupa: Rama i refuzuar në OKB!

E Diela e I e Llukait/ Kryepiskopi Joan: Bota ka nevojë për dritë shpirtërore

Një vit nga fronëzimi i Mitropolitit të Korçës, Hirësisë së Tij Anastas

Kur do të kërkojë falje Veliaj për mashtrimet prej 405 ditësh?

Gara "Tiranathlon"/ Ja akset që do të bllokohen sot në kryeqytet

Nesër gara "Tiranathlon"/ Ja akset që bllokohen në kryeqytet

Tragjedia me 3 viktima shqiptare në Athinë/ Reagon Ministria: Pikëlluese

"UÇK, jo në emrin tim"/ Protestë dhe solidarizim në ndeshjen me Bjellorusinë

"Jep dorëheqjen sa më parë"/ Dita e 119-të e protestës, qytetarët i bëjnë thirrje Ramës

PAMJE-Atmosferë kuqezi para sfidës me Bjellorusinë/ Tifozë shqiptarë edhe nga diaspora

"Rama nuk u ndikua"/ Gazetari paralajmëron ngjarje të reja nga skandali i SHISH-it: S'kemi parë gjë akoma

Gazetari zbulon detajet: Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri

Shqipëria nënshkruan konventën e OKB-së kundër krimit kibernetik

"Kam shumë për të thënë..."/ Rikthehet Saimir Tahiri

Si u emëruan krerët e institucioneve, pas ardhjes së Vlora Hysenit në SHISH

Si u kryqëzuan fatet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin

Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë

Dita e emrit të Kryepiskopit Joan, mesazhi i Fortlumturisë së Tij: Duajeni njëri-tjetrin


Merr zyrtarisht detyrën në Shqipëri/ Publikohen fotot nga takimi i Begajt me Wendt

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

07:33 Opinione Sadik Bejko

Rasputin, patronazhizmi seksual

21:28 Opinione Erion Dasho

SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?

20:15 Opinione Ilnisa Agolli

Një spiune me moralin e Vlorë Hysenit

Lifestyle

19:00 Lifestyle

I Lumi i kafesë me uthull. Ia truku praktik nër nastrimin e kuzhinës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.